



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 21.05.2026

VENDIM

Nr. 15 Datë 21 /05 /2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHES

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Enjte , më datë 28.05.2026, **ora 12:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 30.04.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.04.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Prill 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës emërore për aplikuesit/ familjet e subvencionimit të qerasë në Bashkinë Pogradec.
7. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 14 Ha dhe 7962 ,2, të ndodhura në Njësinë Administrative Trebinjë që mund të jepen me qira.
8. **Projekt – Vendim:** Për nje ndryshim ne VKB nr 128 dt 22.12.2025“ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026", (numri i punonjesve)
9. **Projekt – Vendim:** Për një rishperndarje në VKB nr 128 dt 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"
10. **Projekt – Vendim:** Për nje rishperndarje ne VKB nr 128 dt 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2026"

11. Informacion mbi raportin vjetor të performancës së Bashkisë për vitin 2025.

12. Të tjera.

Ngarkohet Sekretarja e Këshillit , në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale,lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për cdo këshilltar, te kryetari I Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari I Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

